SHQIPËRIA Bëhet

KQZ
U PROTOKOLLUA
Nr. 1210 Prot.
Datë,më 18.5.2026

Nr. 197 Protokolli Tiranë, më 14/05/2026

KËRKESË

KËRKUES: Partia "Lëvizja Shqipëria Bëhet", e regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me Vendim nr. 5, datë 30.09.2024, përfaqësuar nga Kryetari, z. Adriatik Lapaj.

DREJTUAR: Ministrisë së Punëve të Brendshme

PËR DIJENI: Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

OBJEKTI: Kërkesë për kompensimin e qirasë për selinë qëndrore të Partisë "Lëvizja Shqipëria Bëhet".

BAZA LIGJORE: **Kushtetuta** e Republikës së Shqipërisë, neni 45, neni 100;
Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar;
VKM Nr. 255, datë 20.04.2023 *"Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për llojin e dokumenteve, për procedurën administrative të shqyrtimit të kërkesës, mënyrën e pagesës, numrin e ndërtesave për zyrat vendore dhe për kufijtë maksimalë të qirasë për zyrat qendrore dhe vendore të partive politike".*

Të nderuar,

Në zbatim të Nenit 48 i Kushtetutës dhe në funksion të respektimit të parimeve demokratike të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ju paraqesim këtë kërkesë për pajisjen me seli qëndrore në territorin e Bashkisë Tiranë, për ushtrimin e aktivitetit të Partisë "Lëvizja Shqipëria Bëhet".

Bazuar në **Ligjin Nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike", neni 22 pika b**, i cili përcakton se: *"Shteti lehtëson veprimtarinë e partive politike. Lehtësimi nga shteti i veprimtarisë së partive politike përfshin fushat si vijon: b) partitë parlamentare pajisen me ndërtesë për selinë e tyre qendrore dhe zyra vendore"*, kemi kërkuar në rrugë shkresore Bashkisë Tiranë me shkresën nr. 36002 Prot, dt. 17.20.2025 dhe Ministrisë së Brendshme me shkresën Nr. 118 Prot, dt. 15.10.2025 të njoftohemi mbi disponueshmërinë tuaj lidhur me pajisjen me seli qëndrore për subjektin tonë.

Nga ana Bashkisë, na është komunikuar përfundimisht me shkresën Nr. 3623 Prot. dt.26.01.2026 se nga verifikimi i listës së pronave të paluajtshme shtetërore në pronësi të Bashkisë Tiranë, të miratuara me VKM-të përkatëse si edhe listës së pronave në pronësi të Bashksië Tiranë, rezulton se nuk disponojnë zyra në pronësinë të tyre, që të plotësojnë kriteret dhe kushtet e kërkesës tonë.

Nga ana tjetër, Ministria e Punëve të Brendshme me shkresën Nr. 5416/3 Prot, dt. 09.04.2026 na ka vënë në dispozicion shkresën përcjellëse të Agjencisë Shtetërore të

Tel: +355 69 955 4829
Email: info@shqiperiabehet.al
Adresa: Rr. Jeronim De Rada, Tiranë
web:www.shqiperiabehet.al

Kadastrës me Nr. 6081/2 Prot (Juaj), dt. 18.02.2026 sipas së cilës rezulton se ka pamundësi për përmbushjen e kërkesës tonë për pajisjen me seli qëndrorë në Bashkinë Tiranë, për shkak të procesit të ristrukturimit në këtë Agjenci.

Procesi i ristrukturimit nuk duhet të jetë në asnjë rast pengesë për vijimin e procedurave që parashikon ligji. Në këtë kuadër, bazuar në **Nenin 22/1 pika 2** të Ligjit Nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar, i cili përcakton se: "*Kur nuk gjenden ndërtesa të lira, shteti merr përsipër pagesën e qirasë së selisë qendrore dhe të zyrave vendore të partisë politike*" kërkojmë që të vijojmë me kompensimin e qirasë sipas Kontratës së Qirasë me Nr. 3119 Rep. dhe Nr. 1173, dt. 11.02.2026 për selinë qëndrore të ndodhur në Bashkinë Tiranë.

Bashkëlidhur, ju dorëzojmë:

- Kontratën e Qirasë Nr. 3119 Rep. dhe Nr. 1173 Kol, dt. 11.02.2026 – origjinale
- Korrespondencën tonë me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Bashkinë Tiranë – kopje.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të përgjigjes suaj zyrtare, në afatet e parashikuara nga ligji.

Me respekt,
Kryetari
Z. Adriatik Lapaj

PARTIA LËVIZJA SHQIPËRIA BËHET

Tel: +355 69 955 4829
Email: info@shqiperiabehet.al
Adresa: Rr. Jeronim De Rada, Tiranë
web:www.shqiperiabehet.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER PERIAN B. BODINAKU
ADRESA Ç. TOPULLI
TEL: 674010104

KONTRATË QIRAJE

(PASURI TË PALUAJTSHME)

Nr. repertori: 3119 **Nr. koleksioni: 1173**

Tirane më 11/02/2026

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2026052640104680912

A20260526401046809 12

KONTRATË QIRAJE

Sot, më datë _____, para meje Noterе PERIAN B. BODINAKU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Ç. TOPULLI, u paraqit personalisht:

QIRADHËNËS:
Haki Hallaçi, atësia Idriz, amësia Fatime, shtetas Shqiptar, lindur në Pobreg, Kukës dhe banues në DURRËS, me adresë Kenete 00800076; Nd. 18/1; H. 1; Katundi i Ri; Rinia; 2017; Durrës, lindur më 21/01/1961, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 039651815 dhe nr. personal G10121130N.

*(këtu e më poshtë, për efekt të kësaj kontrate do të quhet **Qiradhënës**).*

QIRAMARRËS:
Partia "Lëvizja Shqipëria Bëhet", regjistruar si person juridik pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm me Nr. Vendimi 5, dt. 30.09.2024, me numër unik identifikimi të subjektit NIUS M42404451D, me adresë Tirane, Rruga 'Jeronim de Rada', përfaqësuar nga Kryetari Adriatik Lapaj, atësia Ferman, amësia Florida, shtetas Shqiptar, lindur më 09/06/1988, në Sarandë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr. Myrtezim Këlliçi, Pall. Al-FAM, Ap. 26, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID Nr. 032324093 dhe Nr. Personal I80609129K.

*(këtu e më poshtë, për efekt të kësaj kontrate do të quhet **Qiramarrës**).*

Palët deklaruan se me vullnetin e tyre të lirë lidhin këtë Kontratë Qiraje (këtej e tutje referuar si "Kontrata"), me kushtet si me poshtë vijon:

NENI 1. OBJEKTI I KONTRATES

Dhënia me qira e pasurive të llojit 'Njësi', duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e Qiradhënësit dhe të Qiramarrësit gjatë ushtrimit të së drejtës së qirasë në ambientin e përcaktuar në Nenin 2 të kësaj Kontrate, në përputhje me nenet 801 e vijues të Kodit Civil.

Pala qiradhënëse deklaron se asnjëra nga pasuritë objekt i kësaj kontrate nuk është e bllokuar apo e rënduar me kredi bankare ose me të drejta të palëve të treta, duke marrë përsipër të gjitha përgjegjësitë ligjore që rrjedhin nga ky deklarim

NENI 2 PËRSHKRIMI I OBJEKTIT QE JEPET ME QIRA

2.1 ***Qiradhënësi*** vërteton pronësinë mbi pasuritë e dhëna me qira, nëpërmjet Kontratës së Shitjes së Pasurisë së Paluajtshme Nr.2931 Rep., Nr.727 Kol., date 04/11/2022.
Qiradhënësi, Haki Hallaçi, është pronar i pasurive të paluajtshme si më poshtë vijon:

"Njësi", me Nr. Pasurie **6/605-N2**, me sipërfaqe **95.50 m²** (nëntëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë), ZK **8150**, ndodhur në Rr. **"Jeronim De Rada"**, Tiranë.
• **"Njësi"**, me Nr. Pasurie **6/605-N1/2**, me sipërfaqe **68.21 m²** (gjashtëdhjetë e tetë pikë njëzet e një), ZK **8150**, ndodhur në **Tiranë**.

2.2 Qiradhënësi deklaron se gëzon të drejta të plota pronësie mbi pasuritë e cituara më sipër.

A20260526401046809 12

2.3 Qiradhënësi garanton Qiramarrësin se Objekti është i ndërtuar në përputhje me parametrat teknike dhe me cilësi të lartë.
2.4 Pasuritë do të përdoren nga Qiramarrësi për zyra të subjektit përkatës.

NENI 3. PRONESIA

3.1 Qiradhënësi vërteton pronësinë mbi këto pasuri nëpërmjet Kontratës së Shitjes së Pasurisë së Paluajtshme nr. 2931 Rep., nr. 727 Kol., datë 04.11.2022.

NENI 4. AFATI I KONTRATES

4.1 Kjo Kontratë lidhet për një afat **1 (një) vjeçar**, duke filluar nga e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
4.2 Palët mund të bien dakord për zgjatjen e afatit të kësaj Kontrate edhe për periudha të tjera, nën të njëjtat kushte, me kusht që Qiramarrësi t'i paraqesë Qiradhënësit një propozim me shkrim jo më vonë se **30 (tridhjetë) ditë** përpara datës së përfundimit të afatit të Kontratës.
4.3 Qiradhënësi nuk mund të refuzojë rinovimin e Kontratës me të njëjtat kushte, nëse kjo kërkohet nga Qiramarrësi, përveç rastit kur palët nuk arrijnë një marrëveshje për çmimin e qirasë pas negociimit.

NENI 5. QIRAJA, MËNYRA E PAGESËS

5.1 Për pasuritë e marra me qira sipas kësaj Kontrate, Qiramarrësi do t'i paguajë palës qiradhënëse një qira mujore prej **250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë**, e cila do të derdhet në llogarinë bankare të Qiradhënësit **Haki Idriz Hallaçi**, me **IBAN: AL60 2021 2007 0000 0001 2024 3904**, pranë bankës **"Raiffeisen Bank" sh.a.**
5.2 Palët bien dakord që tatimi mbi të ardhurat nga dhënia me qira **(15%)** të pasurisë të paguhet nga Qiramarrësi pranë organeve tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për gjithë periudhën e qirasë.
5.3 Në rast se Qiramarrësi nuk e kryen pagesën e qirasë në afatin e përcaktuar, ai detyrohet t'i paguajë Qiradhënësit një kamatë vonese prej **0.5%** të vlerës së qirasë mujore të papaguar, për çdo ditë vonese.
5.4 Përveç qirasë, Qiramarrësi detyrohet të paguajë çdo muaj, deri në fund të muajit përkatës, të gjitha shpenzimet që lidhen me administrimin e pasurisë, si dhe shpenzimet për furnizimin me ujë, energji elektrike dhe telefon.
Qiradhënësi detyrohet të njoftojë me shkrim Qiramarrësin për çdo ndryshim të llogarisë bankare, të paktën **5 (pesë) ditë** përpara datës së pagesës së qirasë.

NENI 6. PËRDORIMI I OBJEKTIT TË MARRË ME QIRA

6.1 Pasuria jepet me qira për t'u përdorur nga Qiramarrësi **vetëm** sipas përcaktimit të Nenit **2.4** të kësaj Kontrate.
6.2 Qiramarrësit nuk i lejohet, në asnjë rast, të kryejë ndërtime, riparime apo ndryshime në Objekt që cenojnë strukturën e pasurisë, përfshirë konstruksionin dhe hidroizolimin, pa miratimin paraprak me shkrim të Qiradhënësit.
6.3 Për sigurimin e kushteve të përshtatshme për përdorimin e Objektit, Qiramarrësi mund të kryejë rregullime dhe/ose riparime të brendshme pa miratimin paraprak me shkrim të Qiradhënësit, me kusht që këto të mos ndryshojnë strukturën, konstruksionin dhe arkitekturën e Objektit, sipas përcaktimit të pikës **6.2**.
6.4 Qiramarrësit i ndalohet të grumbullojë ose depozitojë në Objektin e marrë me qira materiale dhe/ose pajisje me përmbajtje toksike, të rrezikshme ose eksplozive, si dhe çdo material tjetër që përbën burim të mundshëm rreziku për pasurinë ose personat.
6.5 Qiramarrësi detyrohet të mos kryejë, të mos lejojë kryerjen dhe të parandalojë çdo veprim apo mosveprim që mund të cenojë të drejtën e pronësisë së Qiradhënësit gjatë gjithë afatit të kësaj Kontrate.

NENI 7. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

7.1 Qiradhënësi garanton se Objekti është në kushte të përshtatshme për përdorim dhe se nuk paraqet asnjë të metë. Nga ana e Qiradhënësit do të kryhet edhe pajisja e ambientit me sistem ngrohje–ftohje, dhe mirëmbajtja e tij.

7.2 Qiradhënësi garanton Qiramarrësin nga çdo pretendim i palëve të treta në lidhje me pronësinë mbi pasuritë. Në rast konstatimi të ndonjë mosmarrëveshjeje lidhur me pronësinë apo posedimin e Objektit ndërmjet Qiramarrësit dhe ndonjë të treti, Qiradhënësi detyrohet ta zgjidhë atë personalisht, duke kapërcyer çdo pengesë që cenon ose kufizon përdorimin e Objektit nga Qiramarrësi, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

7.3 Qiradhënësi garanton përdorimin e lirë dhe të qetë të Objektit dhe angazhohet të mos hyjë në Objekt pa dijeninë dhe miratimin paraprak të Qiramarrësit, përveç rasteve të domosdoshme ose emergjente.

7.4 Qiradhënësi garanton hyrjen dhe përdorimin e lirë të Objektit (përfshirë edhe ambientet e përbashkëta të godinës) nga Qiramarrësi, si dhe nga drejtuesit, punonjësit, vartësit, bashkëpunëtorët dhe çdo person i tretë që ka lidhje, në çfarëdo rrethane, me Qiramarrësin, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.

7.5 Qiradhënësi garanton se do të njoftojë Qiramarrësin me shkrim për çdo ndryshim të adresës së tij, brenda **1 (një) javë** nga data e këtij ndryshimi.

7.6 Qiradhënësi angazhohet t'i japë asistencën e nevojshme Qiramarrësit në rast se ky i fundit kërcënohet ose pengohet nga palë të treta që pretendojnë të drejta pronësie ose që, me veprime arbitrare, cenojnë përdorimin e lirë dhe të qetë të Objektit.

7.7 Qiradhënësi garanton se do të caktojë një përfaqësues si person kontakti në rast mungese, i cili do të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë Qiradhënësit sipas kësaj Kontrate.

7.8 Qiradhënësi garanton se do të jetë i vetmi subjekt përgjegjës për çdo pretendim që rrjedh ose lidhet me statusin e tij ligjor mbi Objektin.

NENI 8. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRESIT

Qiramarrësi detyrohet të:

a) përdorë Objektin vetëm për qëllimin e përcaktuar në këtë Kontratë;
b) respektojë të gjitha kushtet dhe detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë;
c) mbajë Objektin në kushte të pastra dhe të rregullta sanitare;
d) paguajë, gjatë gjithë kohëzgjatjes së qirasë, çdo shpenzim të nevojshëm që lidhet me administrimin e Objektit, përfshirë faturat e ujit, energjisë elektrike, telefonisë, si dhe çdo shpenzim tjetër që i takon sipas legjislacionit në fuqi;
e) paguajë në kohë qiranë dhe çdo shumë tjetër që detyrohet sipas kësaj Kontrate;
f) kthejë Objektin Qiradhënësit në të njëjtën gjendje në të cilën i është dorëzuar, në përputhje me Procesverbalin e dorëzimit, përjashtuar konsumimin normal si pasojë e përdorimit të rregullt, si dhe ndryshimet ose përmirësimet e lejuara sipas kësaj Kontrate;
g) kryejë riparime apo ndryshime në Objekt vetëm në përputhje me përcaktimet e Nenit **6** të kësaj Kontrate;

h) vendosë arredimin, postet e punës dhe pajisjet e brendshme të nevojshme për funksionimin e zyrës, të cilat janë në pronësi të Qiramarrësit dhe që ky i fundit ka të drejtë t'i largojë në përfundim të Kontratës, me kusht që të mos dëmtohet Objekti.

NENI 9. RIPARIMET DHE MIRËMBAJTJA

9.1 Palët bien dakort se Qiradhënësi duhet të sigurojë funksionimin dhe mirëmbajtjen normale te Objektit. Bëjnë këtu përjashtim, shpenzimet në lidhje me riparimet e vogla të mirëmbajtjes që lidhen me konsumin për shkak të përdorimit, të cilat janë në ngarkim të Qiramarrësit.

9.2 Qiramarrësi do të informojë Qiradhënësit në kohë të arsyeshme për riparimet në lidhje me te metat e objektit te marrë me Qira kur këto riparime janë të nevojshme dhe ne rast se per cdo arsye kërkohet kryerja e riparimeve ne Objekt. Në rast keqpërdorimi të Objektit nga ana e Qiramarrësit, shpenzimet për punën dhe materialet e nevojshme për riparimin ose zëvendësimin e tyre do të përballohen prej ketij te fundit.

9.3 Palët bien dakord se, në rast se Qiradhënësi nuk kryen riparimet e nevojshme sipas Nenit 9.1 brenda **24 (njëzet e katër) orëve** (për riparime që lidhen me problematika të ndërtimit), Qiramarrësi ka të drejtë t'i kryejë vetë këto punime dhe/ose riparime, pasi të ketë njoftuar me shkrim Qiradhënësin. Qiradhënësi detyrohet të paguajë të gjitha shpenzimet e lidhura me këto punime.

9.4 Qiramarrësi është i detyruar të përgjigjet për mirëmbajtjen dhe pastrimin e ambienteve të përbashkëta si shkallët në përputhje me legjislacionin dhe rregulloren e ndërtesës mbi bashkëpronësinë e detyrueshme (condominio), nëse ka.

NENI 10. SIGURIMI

10.1 Qiradhënësit duhet te marrin masat e duhura per te mbajtur te siguruar Objektin, nga rreziqe te mundshme si psh zjarri, tërmeti, përmbytja, përgjegjësia civile ndaj te treteve, etj. gjate gjithë periudhës se Qiradhënies. Ne te gjitha këto raste përfitues i sigurimit është Qiramarrësi

10.2 Qiramarrësi ruan të drejtën të lidhë në emër të tij dhe me shpenzimet veta policë sigurimi për Objektin apo pergjegjesi apo pasuri në pronësi të Qiramarrësit ose në pronësi të personave të tretë por që ndodhen, mbi bazën e çfarëdo titulli, në posedim dhe/ose në disponim të Qiramarrësit për përmbushjen e qëllimeve të objektit të shoqërisë të këtij të fundit.

NENI 11. INSPEKTIMI I OBJEKTIT

11.1 Qiradhënësit kane të drejtë të inspektojnë në çdo çast gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate nëse Objekti përdoret në përputhje me qëllimin e parashikuar ne këtë Kontratë, si dhe t'i bëjë Objektit riparime, ndryshime, përmirësime dhe/ose shtesa që Qiradhënësi mund t'i kryejë, sipas bindjes së tij, vetëm pas miratimit të Qiramarrësit (i cili nuk duhet të refuzohet apo të vonohet pa arsye).

11.2 Qiradhënësit kane të drejtë të autorizojë agjentë, kontraktorë apo konsulentë për të hyrë në objektin e dhënë me Qira për qëllimin e sipërpërmendur.

NENI 12. NË RAST SHITJE TË OBJEKTIT

Në rast se Qiradhënësi, në cdo kohë gjatë afatit të kësaj Kontrate, dëshiron të shesë ambjentet, Blerësi i ri është i detyruar të respektoj këtë kontratë qiraje.

NENI 13. ZGJIDHJA E KONTRATËS NGA QIRADHËNËSI

13.1 Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj Kontrate para afatit në rast se:

a. Qiramarrësi nuk ka paguar qiranë ose detyrimet e tjera që i takojnë sipas kësaj Kontrate brenda **30 (tridhjetë) ditëve** nga data e përcaktuar për pagesë sipas kësaj Kontrate;

b. Qiramarrësi, me fajin e tij, dëmton rëndë Objektin dhe nuk merr masa për riparimin e këtyre dëmtimeve brenda **30 (tridhjetë) ditëve** nga marrja e njoftimit me shkrim nga Qiradhënësi;

c. Qiramarrësi përdor Objektin për qëllime që bien ndesh me ato të parashikuara në këtë Kontratë dhe nuk korrigjon këtë shkelje brenda **30 (tridhjetë) ditëve** nga marrja e njoftimit me shkrim nga Qiradhënësi.

13.2 Qiradhënësi mund të bëjë zgjidhjen e Kontratës sipas Nenit 15.1 vetëm duke i dërguar Qiramarrësit një njoftim me shkrim, me **letër rekomande me kthim përgjigje**, të paktën **30 (tridhjetë) ditë** përpara datës së parashikuar për zgjidhje. Megjithatë, në çdo rast, zgjidhja e Kontratës sipas Nenit 15.1 mund të bëhet vetëm me pëlqimin me shkrim të **të gjithë Qiradhënësve**; përndryshe, zgjidhja është e pavlefshme dhe pa efekt.

13.3 Në rast se Kontrata zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga Qiradhënësi pa respektuar procedurat e mësipërme, Qiradhënësi detyrohet të paguajë Qiramarrësit një shpërblim për dëmin, të barabartë me koston e zhvendosjes së Qiramarrësit.

NENI 14. ZGJIDHJA E KONTRATËS NGA QIRAMARRËSI

14.1 Qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë në çdo moment dhe për çdo shkak, duke njoftuar Qiradhënësin me **letër rekomande me kthim përgjigje**, të paktën **2 (dy) muaj** përpara datës kur zgjidhja do të bëhet efektive.

14.2 Gjithashtu, Qiramarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e Kontratës para afatit, duke njoftuar Qiradhënësin me **30 (tridhjetë) ditë** paraprakisht, në rastet kur:

a. vazhdimi i veprimtarisë në Objekt është i pamundur për shkak të dëmtimeve të shkaktuara nga **forca madhore**, dhe riparimi i këtyre dëmtimeve kërkon kohë të gjatë;

b. Objekti bëhet i papërdorshëm për Qiramarrësin si pasojë e akteve kriminale të personave të tretë, pasojave të luftës, trazirave, shqetësimeve publike ose katastrofave natyrore (p.sh. zjarr, përmbytje, etj.);

c. statusi ose titulli i Qiradhënësit mbi Objekt rrezikohet nga pretendime të palëve të treta. Në këtë rast, Qiradhënësi detyrohet të dëmshpërblejë Qiramarrësin për çdo kosto ose shpenzim të kryer si pasojë e zgjidhjes së Kontratës dhe të mbajë Qiramarrësin të padëmtuar derisa ky i fundit të lidhë një kontratë tjetër qiraje, sipas zgjedhjes së tij;

d. Qiradhënësi nuk i siguron Qiramarrësit gëzimin e qetë dhe të lirë të Objektit, dhe Qiramarrësi është në pamundësi për të ushtruar aktivitetin e tij për një periudhë që i kalon **15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike**, për shkaqe për të cilat Qiradhënësi është përgjegjës drejtpërdrejt ose tërthorazi.

14.3 Qiramarrësi mund të realizojë zgjidhjen e Kontratës sipas Nenit 14.2 vetëm duke dërguar Qiradhënësit një **njoftim me shkrim, me letër rekomande me kthim përgjigje**, të paktën **30 (tridhjetë) ditë** para datës së zgjidhjes së Kontratës.

14.4 Në rast zgjidhjeje të Kontratës për një nga arsyet e sipërpërmendura, Qiramarrësi duhet t'i dorëzojë Objektin Qiradhënësit në përputhje me përcaktimet e Nenit 6 të kësaj Kontrate.

A20260526401046809 12

NENI 15. NDRYSHIMET DHE SHTESAT E KONTRATES

Ndryshimet ose shtesat e kësaj Kontrate janë të vlefshme vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dyja palët.

NENI 16. KONTRATA SI E TËRË

Kontrata me kushtet dhe afatet e saj do të interpretohet si një e tërë. Në rast se ndonjë nen ose frazë krijon paqartësi, duhet të shikohet në kontekstin e tërë Kontratës dhe sipas qëllimit për të cilën palët kanë lidhur këtë Kontratë.

NENI 17. PAVLEFSHMERIA E PJESSHME E KONTRATES

Në rast se ndonjë nga nenet e kësaj Kontrate është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm, atëherë ky nen do të veçohet; pavarësisht nga kjo, të gjitha nenet e tjera të kësaj Kontrate do të mbeten në fuqi dhe të vlefshme. Asnjë nen i kësaj Kontrate nuk do të varet nga nene të tjera, përderisa nuk është shprehur ndryshe në Kontratë.

NENI 18. GJUHA E KONTRATES

Kjo Kontratë është hartuar ne 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

NENI 19. LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI

Interpretimi i kësaj Kontrate do të bëhet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 20. ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve në lidhje me këtë Kontratë do të shqyrtohen nga Gjykatat e Shkallës së Parë, Tiranë.

NENI 21. NJOFTIMET

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve në kuadër të kësaj Kontrate do të bëhen **me shkrim**, duke u dorëzuar personalisht personave përfaqësues ose atyre të ngarkuar me përgjegjësi, **me anë të postës rekomande**, ose përmes **njoftimit nga noteri**, në adresën e mëposhtme (ose në një adresë tjetër të cilën palët ia kanë komunikuar më parë njëra-tjetrës):

- **Për Qiradhënësin:** Nr. Tel: 0682368257
- **Për Qiramarrësin:** Nr. Tel: 0699554829

NENI 22. HYRJA NE FUQI

Kjo Kontratë hyn në fuqi pas përmbushjes së kushteve të mëposhtme:

a) nënshkrimi i saj nga të dyja palët përpara një noteri; dhe
b) dorëzimi i pasurisë nga ana e Qiradhënësit.

NENI 23. DOKUMENTACIONI BASHKANGJITUR

Dokumentet e mëposhtme i bashkëngjiten kësaj Kontrate dhe bëhen pjesë e saj integrale:

a) Dokumentacioni i pronësisë mbi Objektin;
b) Kartelat e pasurive;

A20260526401046809I2

Kontrata e qirasë, u lexua nga unë noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Notereś në 5 (pesë) kopje.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, unë Noteria deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

QIRADHËNËS

Haki Hallaçi

QIRAMARRËS

Partia "Lëvizja Shqipëria Bëhet"
Përfaqësuar nga Kryetari:
Adriatik Lapaj

NOTERE

PERIAN B. BODINAKU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ELIDA MAGANI
ADRESA NR.2,Rruga G.W.BUSH, Kulla 2,Hyrja 24,Tirane
TEL: 0696695964

KONTRATË SHITJE PASURI E PALUAJTSHME

(KONTRATË SHITJE PASURI E PALUAJTSHME ME REZERVË PA KALIM PRONËSIE)

Nr. repertori: 2931 **Nr. koleksioni: 727**

Tirane më 04/11/2022

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

A20220542500729963 67

A26220548500729856T

KONTRATE SHITJE PASURI TE PALUAJTSHME
(NJESI)
me rezerve pa kalim pronesie

Sot, me datë 04.11.2022, para meje Noterе ELIDA MAGANI (SULA), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.2, Rruga G.W.BUSH, Kulla 2, Hyrja 24, Tirane, u paraqiten personalisht:

NENI 1
PALET PJESEMARRESE NE KETE KONTRATE

SHITES: Shoqëria R E N I S shpk, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K32119003B, me adresë Rruga Jeronim De Rada, Zona Kadastrale Nr. 8150, Nr. Pasurie 6/161, përfaqësuar nga **Administratori Fatmir Hoxha,** atësia Hamdi, amësia Haxhire, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tirane, me adresë Daxhit 03910025; Nd. 205; H. 1; Farkë; Farkë e Vogël; 1045; Tiranë, lindur më 25/11/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038338463 dhe nr. personal G91125155T. *(këtu e më poshtë, për efekte të kësaj kontrate referuar si **Shitësi**).*

BLERES: Haki Hallaçi, atësia Idriz, amësia Fatime, shtetas Shqiptar, lindur në Pobreg, Kukës dhe banues në Durres, me adresë Kenete 00800076; Nd. 18/1; H. 1; Katundi i Ri; Rinia; 2017; Durrës, lindur më 21/01/1961, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032665229 dhe nr. personal G10121130N, (këtu e më poshtë, për efektet e kësaj kontrate referuar si **Blerësi**).

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 83, 705 e vijues i tij, ligjit nr. si dhe ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën", neneve 62, 63, 105, 106, 108, 126, 127 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja hartimin e Kontratës së Shitjes Pasuri te Paluajtshme - Njesi me rezerve pa kalim pronesie, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

NENI 2
BAZA LIGJORE

1. Baza Ligjore e Kontratës së Shitjes është:

- Kodi Civil, nenet 83, 164, 192, 705,dhe 750 e vijues;
- Kodi i Familjes, nenet 73, 74/a e vijues;
- Ligji110/2018, datë 20.12.2018 "*Për Noterinë*", nenet 105/3, 105/4;105/5 neni 127 e vijues;
- Ligji nr. 111/2018, datë 07.02.2019 "*Për Kadastrën*", neni 42 e vijues;
- Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhenave personale*"
- Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 "*Për tatimin mbi të Ardhurat*", i ndryshuar
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave Vendore*", i ndryshuar
- Udhëzim i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.20 datë 14.09.2020 "Për procedurën teknike për kryerjen e pagesës në rastet e kalimit të pasurive të paluajtshme",

Udhëzimi nr. 29 date 30.07.2018 *"Për njatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë se paluajtshme"*

NENI 3
OBJEKTI I KONTRATES

Objekti i kesaj kontrate eshte shitja me rezerve nga ana e shitesit dhe blerja nga ana e bleresit e pasurive te meposhtme:

Njesi, pasuria me nr.6/605-N2, me siperfaqe 96.50 (nentedhjete e pese pike pesedhjete) m2, zona kadastrale 8150, volumi 60, faqe 245, ndodhur ne Rrugen: "Jeronim De Rada", Tirane, rregjistruar ne ZVRPP Tirane sipas Certifikates per vertetim pronesie 1768040 leshuar me date 01.10.2018.

dhe

Njesi, pasuria me nr.6/605-N1/2, me siperfaqe 68.21 (gjashtedhjete e tete pike njezete e nje) m2, zona kadastrale 8150, volumi 63, faqe 249, ndodhur ne Tirane, rregjistruar ne ZVRPP Tirane sipas Certifikates se regjistrimit te pronesise te leshuar me date 11.03.2021 nga ZVRPP Dr.Vendore Tirane Veri.

Sipas kartelave te pasurise dhe verifikimit te bere nga une noteria pronat jane te bllokuara per llogari te Bankes se Bashkuar te Shqiperise, sipas shenimit ne seksionin D, "Kufizimet e Pronesise".

NENI 4
CMIMI I SHITJES

Çmimi i shitjes se Njesive te siper pershkruara eshte 130.000 (njeqind e tridhjete mije) Euro, shume e cila do te paguhet me keste si vijon:

1.Kesti i pare ne shumen 45.000 (dyzete e pese mije) Euro do te paguhet ne favor te shitesit me lidhjen e Kontrates se shitjes me rezerve te Njesive dhe do te derdhet ne Banken BKT.

2.Kesti i dyte ne shumen 85.000 (tetedhjete e pese mije) Euro (ose 14.166 Euro cdo 6 muaj) do te derdhet brenda nje afati prej 24 (njezete e kater) muaj nga nenshkrimi i kontrates ne llogarine bankare te Shitesit ne BKT

Palet kane rene dakort qe vetem vlera prej 14.166 Euro e 6 mujorit te fundit, qe ploteson likuidimin e kestit te dyte prej 85.000 euro do te derdhet ne llogarine bankare te tjetersimit te notere Elida Magani (Sula), me lidhjen e Kontrates perfundimtare te shitjes.

Ne momentin qe bleresi do te paiset me dokumente pronesie poteri do te kaloje ne llogarine e shitesit kestin e fundit prej 14.166 Euro, sipas kushteve te percaktuara ne Kontraten perfundimtare te shitjes.

Cmimi i shitjes se Njesise N2 eshte 95.000 (nentedhjete e pese mije) Euro.

Cmimi i shitjes se Njesise N1/2 eshte 35.000 (tridhjete e pese mije) Euro

NENI 5
TE DREJTA DHE DETYRIME TE SHITESIT

4.1 Shitesi ka detyrim te garantoje bleresin se Njesite objekt shitje do te lirohen nga barra hipotekore deri ne momentin e nenshkrimit te Kontrates Perfundimtare.
